

LIGJ
Nr.8352, datë 27.5.1998

PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.2101, DATË 21.5.1998 "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7573, DATË 16.6.1992 "PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË PUSHTETIT LOKAL", I NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7593, DATË 29.7.1992; NR.7798, DATË 23.2.1994; NR.1579, DATË 13.8.1996; NR.8151, DATË 12.9.1996 DHE NR.8346, DATË 13.5.1998"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet dekreti nr.2101, datë 21.5.1998 "Për një ndryshim në ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", i ndryshuar me ligjet nr.7593, datë 29.7.1992; nr.7798, datë 23.2.1994; nr.1579, datë 13.8.1996; nr.8151, datë 12.9.1996 dhe nr.8346, datë 13.5.1998" me këto ndryshime:

Në nenin 1, në paragrafin e tretë bëhen këto ndryshime:

1. Para fjalëve "9 orësh" dhe "tri orësh" të shtohet fjala "e shumta".
2. Në fund të nenit shtohet kjo fjali: "Ndërkohë Komisioni Qendror vazhdon veprimtarinë e vet për çështje të tjera.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.